

STATUTI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
MARKU T.C.I SHPK

Neni 1

Emertimi

- 1.1 Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "**MARKU T.C.I**" SHPK (ne vijim e quajtur "**Shoqeria**") themelohet ne zbatim te Ligjit nr. 9901, date 14.04.2008 "*Per tregtaret dhe shoqerite tregtare*" si ndryshuar.
- 1.2 Shoqeria fiton personalitet juridik ne momentin e regjistrimit te saj ne Regjistrin Tregtar shqiptar prane Qendres Kombetare te Biznesit ne Tirane, Shqiperi.

Neni 2

Selia

- 2.1 Selia e Shoqerise ndodhet ne adresen: rruga Demokracia, Zona Kadastrale 2066, ndertesa nr. 172, Bathore, Kamez, Shqiperi.
- 2.2 Shoqeria mund te hape dhe te kryeje aktivitet ne vende te tjera brenda territorit te Republikes se Shqiperise ne perputhje me legjislacionin shqiptar.

Neni 3

Objekti i Shoqerise

- 3.1 Shoqeria do te kete per objekt te aktivitetit:
- Ndertim objektesh te permasave te ndryshme, shtepi, vila, ndertesa shume kateshe ose komplekse banimi, punime dheu, sistemime, taracime terenesh, ndertime civile, industriale turistike, bujgesore etj dhe kompletimin me instalimet e nevojeshme per to, kulla uji per betonarmeje, themele te vecanta , rikonstniksione godinash civile dhe ekonomike, montimi dhe instalimi i impianteve termike te ventilitimit dhe kondicionimit te ajrit dhe mirembajtja e tyre, ndertim rruge, ura, autostrada, punime te mirembajtjes, sinjalizimit dhe vijeimit ne rruge, karpentiere, punime te siperfaqeve te gjelberta, parqe, pyllparqe etj ne mjedise urbane mirembajtja e zhvillimit te dekorit, vepra arti, import-export dhe prodhim, ndertim te materialeve te ndertimit si dhe mallrat e ndryshme.
- Marrja persiper e projektimit dhe/ose zbatimit te punimeve te ndryshme ne fushen e ndertimit per llogari te te treteve, qofshin keto persona juridike dhe/ose fizike, publike dhe/ose private dhe /ose per llogari te saj, brenda ose jashte vendit, vete ose ne bashkepunim me cdo lloj strukture tjeter, qofshin keta. persona juridik vendas apo te huaj.
- Marrja, persiper e projektimit dhe/ose zbatimit et punimeve te montimit te teknologjive, impiant'eve industriale, te prodhimit dhe shpendarjes se energjise elektrike etj. dhe/ose sherbimet e mirembajtjes se tyre. Realizimi i projektimit dhe/ose zbatimit te veprave te vecanta dhe punimeve speciale si sillosa,, kulla, punime themeli, vepra hidroteknike, vepra arti rugore dhe hekurudhore, ndertime detare, rruge Vpolte, aeroporte etj. dhe/ose sherbimet e mirembajtjes es tyre. Marrja persiper dhe realizimi i studimeve, kerkimeve dhe/ose hartimi i projekteve teknike ne, fusha te ndryshme ne lidhje kryesisht me aktivitetet ne fushen e ndertimit, por jo vetem. Mund te kryeje cdo operacion financiar tregtar, sherbimi, industrial, me pasuri te luajtshme ose te paluajtshme, Agjensi imobilare (i) ("**Objekti**");
- 3.2 Shoqeria mund te kryeje aktivite te tjera te dobishme ose te nevojshme te cilat jane te lejara me ligj, ne menyre qe te mund te ushtroje objektin e Shoqerise.

Neni 4

Kohezgjatja

- 4.1 Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj per nje periudhe kohore te pakufizuar.
- 4.2 Shperberja dhe mbyllja e Shoqerise do te percaktohet me ane te vendimit te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve (siç percaktohet me poshte), sipas dispozitave te ketij Statuti dhe ligjit ne fuqi.

Neni 5

Kapitali

- 5.1 Kapitali themeltar i Shoqerise eshte 100.000 ALL (njeqind mije Leke), ("**Kapitali**") dhe do te ndahet ne 2 kuota me vlere si me poshte:
- Z. Mark Marku do te zoteroje 1(nje) kuote, me vlere 50.000 Leke (pese mije Leke) dhe perben 50% Kapitalit te Shoqerise.
- Z. Marjo Marku do te zoteroje 1(nje) kuote, me vlere 50.000 Leke (pese mije Leke) dhe perben 50% Kapitalit te Shoqerise.
- 5.2 Vlera e kapitalit do te shlyhet ne llogarine bankare te Shoqerise.

Neni 6

Ortaket dhe Kontributet e tyre ne Kapital

- 6.1 Ortaket e Shoqerise jane:
- **Z. Mark Marku**, shtetas shqiptar, lindur me 15.06.2003 ne Athine, banues ne Kamez, i pajisur me mjet identifikues me Nr. Personal K30615068F.
 - **Z. Marjo Marku**, shtetas shqiptar, lindur me 04.08.2004 ne Tirane, banues ne Kamez, i pajisur me mjet identifikues me Nr. Personal K40804103T.
(ne vijim referuar si "**Ortaket**")
- 6.2 Ortaket kane pergjegjesi te kufizuar deri ne kufirin e vleres se kontributit ne Kapitalin e Shoqerise.
- 6.3 Kontributi i Ortakeve ne Kapitalin e Shoqerise mund te jete ne para ose cdo lloj tjetër ne formen e pasurise se luajtshme ose te paluajtshme ose te drejta.
- 6.4 Shoqeria, me kerkese te administratorit dhe ne perputhje me dispozitat e ligjit, mund te marre financime te ripagueshme nga Ortaket.
- 6.5 Adresat e Ortakeve do te jene te regjistruara ne regjistrin e Ortakeve ("**Regjistri i Ortakeve**"). Ortaket jane te detyruar te njoftojne Shoqerine per cdo ndryshim te adreses se tyre. Shoqeria ka te drejte te mbaje dhe ruaje kete Regjister dhe ta perditesoje ate ne perputhje me rrethanat.

Neni 7

Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit

- 7.1 Kapitali i Shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nenshkrimeve te pjeseve te kapitalit themeltar per kontributet ne para dhe me ane te kontributeve ne natyre, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e nje eksperti te autorizuar per keto kontribute sipas kerkeses se administratorit.
- 7.2 Zvogelimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakeve, e cila merr vendim ne te njejtat kushte qe kerkohen per ndryshimin e statutit.

Neni 8

Transeferimi i kapitalit

- 8.1 Kuotat e kapitalit te nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar e te drejtat qe rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo kalon nepermjet:



- a) kontributit ne kapitalin e Shoqerise;
- b) Shitblerjes;
- c) Trashegimise;
- ç) dhurimit;
- d) cdo menyre tjeter te parashikuar me ligj.

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferushme ndermjet ortakeve, per sa nuk parashikohet ndryshe ne statut.

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme me rruge trashegimie.

Neni 9

Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve dhe Kompetencat e saj

9.1 Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve ("Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve"), ne perputhje me legjislacionin shqiptar dhe kete Statut, eshte organi me i larte vendimmarres i Shoqerise. Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve perfaqeson Ortakun e vetem te Shoqerise.

9.2 Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve merr vendime per ceshtjet e Shoqerise si ne vijim:

- a) percaktimi i politikave tregtare te Shoqerise;
- b) miratimi i ndryshimeve te Statutit;
- c) emerimi e shkarkimi i Administratorit;
- d) emerimi e shkarkimi i likuiduesve dhe eksperteve kontabel te autorizuar si dhe percaktimi i shperblimit te tyre;
- e) mbikeqyrja e zbatimit te politikave tregtare nga Administratori;
- f) miratimi i pasqyrave financiare vjetore dhe raporteve te ecurise se veprimtarise pas shqyrtimit te dokumenteve perkatese, brenda gjashte muajsh nga perfundimi i vitit financiar;
- g) zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit;
- h) pjesetimin e kuotave dhe anullimin e tyre;
- i) caktimin e perfaqesuesit te Shoqerise ne gjykate dhe ne procedime te tjera ndaj Administratorit;
- j) miratimin e riorganizimit te Shoqerise, perfshire bashkimin me shoqeri te tjera, ndarjen e Shoqerise, shnderrimin e Shoqerise si dhe prishjen e Shoqerise;
- k) miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve;
- l) marrja e vendimeve te tjera qe nuk jane ne kompetence te Administratorit.

Neni 10

Perfaqesimi dhe Kuorumi

10.1 Ortaku merr pjese ne Asamblene e Pergjithshme te Ortakeve dhe voton sipas kuotes qe zoteron ne kapitalin e Shoqerise.

10.2 Ortaku mund te perfaqesohen ne Asamblene e Pergjithshme te Ortakeve nga nje person i trete i autorizuar nepermjet prokures me shkrim.

10.3 Pervec se kur parashikohet ndryshe nga Statuti, Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve vendos ne menyre te vlefshme kur ne mbledhje marrin pjese Ortaket me te drejte vote qe perfaqesojne me shume se 30% (tridhjetete perqind) te kapitalit dhe vendimet merren shumicen e thjeshte te Ortakeve te pranishem ne mbledhje.

10.4 Per te vendosur ndryshimin e Statutit, zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit te regjistruar dhe shperndarjen e fitimit, pervec se kur parashikohet ndryshe ne kete Statut, Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve konsiderohet e mbledhur rregullisht kur jane te pranishem ose te perfaqesuar Ortaket qe zoterojne te pakten 50% (pesedhjetë për qind) te kapitalit te Shoqerise dhe vendimi merret me shumice te cilesuar (te pakten 75%) te Ortakeve te pranishem

Neni 11

Menyra e thirrjes se Asamblese se Pergjithshme

11.1 Asambleja e Pergjithshme thirret nepermjet nje njoftimi me shkrese. Njoftimi me shkrese duhet te permbaje vendin, daten, oren e mbledhjes dhe rendin e dites dhe do t'u dergohet te gjithë ortakeve, jo me vone se 7 dite perpara dates se parashikuar per mbledhjen e asamblese.

11.2 Kur Asambleja e Pergjithshme nuk eshte thirrur sipas pikes 1 te ketij neni, ajo mund te marre vendime te viefshme vetem nese te gjithë ortaket jane dakort, per te marre vendime, pavaresisht parregullise.

Neni 12

Administrimi i Shoqerise

- 12.1 Administrator i shoqerise eshte **Z. Mark Marku**, shtetas shqiptar, lindur me 15.06.2003 ne Athine, banues ne Kamez, i pajisur me mjet identifikues me Nr. Personal K30615068F. Administratori i shoqerise do te ushtroje kompetencat e administrimit per nje afat 5 vecar me te drejte ripërteritje.

Neni 13

Kompetencat e Administratoreve

13.1 Administratoret kane kompetencen dhe detyre qe:

- a) te menaxhoje veprimtarine e perditshme tregtare te Shoqerise;
 - b) te perfaqesojë Shogerine ndaj paleve te treta;
 - c) te kryeje transaksione ne kuader te detyrave te tij
 - d) te siguroje qe librat dhe regjistrimet e nevojshme kontabel te mbahen ne menyre korrekte dhe te duhur;
 - e) te pergatise pasqyrat financiare vjetore dhe raportin e performances dhe t'ja paraqese per miratim Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve;
 - f) te krijojë nje sistem monitorimi dhe paralajmerimi te hershem per zhvillimet qe kercenojne ekzistencen e shoqerise;
 - g) te kryeje regjistrimin dhe publikimet e detyrueshme sipas ketij ligji ose ligjeve te tjera;
 - h) t'i raportoje Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe ne rast te perfundimit te transaksioneve me rendesi te vecante per performancën e Shoqerise.
- 13.2 Administratori do te kryeje detyra te tjera te percaktuara me ligj dhe ato detyra te tjera qe here pas here mund te percaktohen nga Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve.

Neni 14

Viti Ushtrimor dhe Pasqyrat Financiare

14.1 Viti ushtrimor i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor te cdo viti.

14.2 Perjashtimisht, viti i pare ushtrimor fillon ne daten e regjistrimit te Shoqerise ne Regjistrin Tregtar dhe perfundon me 31 Dhjetor te po atij viti.

Neni 15

Fitimi dhe Dividendet

Fitimet qe rezultojne nga pasqyrat financiare te miratuara do te shperndahen midis Ortakeve ne proporcion me kapitalin e zoteruar, pervec nese eshte parashikuar ndryshe dhe vendosur nga Ortaket ne mbledhjen e pergjithshme. Me ane te kerkeses se Ortakut ne Pakice, Sponsor i nuk do te refuzoje ne menyre te pa arsyetuar shperndarjen e dividendit.

Neni 16

Eksperti Kontabel i Autorizuar

Eksperti/et emerohen nga Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve. Asambleja e Ortakeve me ane te nje vendimi mund te riemeroje te njejin/et ekspert. Eksperti/et shkarkohet/n nga detyra me vendim te asamblese se ortakeve ne rast mosrespektimi te detyres se tij, ne rast gabimi dhe ne rast mungese profesionalizmi ne sjellje.

Neni 17

Prishja dhe Likuidimi

17.1 Asambleja e Ortakeve mund te vendose per prishjen e Shoqerise. Prishja e Shoqerise do te shoqerohet me likuidimin e saj.

17.2 Shoqeria vazhdon te ekzistojte si person juridik vetem per nevoja te likuidimit deri ne perfundim te ketij procesi dhe gjate likuidimit, togefjaleshi "ne likuidim e siper" duhet te vihet pas emrit te Shoqerise.

17.3 Likuiduesi/t do te emerohet me vendim te Asamblese se ortakeve. Emerimi i likuiduesit/eve dhe procesi i likuidimit do te kryhen ne perputhje me dispozitat e ligjit shqiptar.

Neni 18

Ligji i Zbatueshem

18.1 Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plote me kete Statut dhe me legjislacionin shqiptar.

18.2 Per sa nuk eshte parashikuar ne kete Statut, do te aplikohen dispozitat e ligjit nr. 9901, date 14.04.2008 "Per tregaret dhe shoqerite tregtare", i ndryshuar.

Ky Statut u hartua ne dy kopje ne gjuhen shipe me te njejten vlere dhe u nenshkrua rregullisht nga Ortaku.

ORTAKET

Z. Mark Marku



Mark Marku

Z. Marjo Marku



Marjo Marku

27.08.2025